



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
*Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborna komisija za žalbe i molbe*

# **R A P O R T I P A R Ē V J E T O R**

**Tetor 2009 – Korrik 2010**

KZAP, Rr. “Nëna Terezë” pn. Ndërtesa e ish Gërmisë kati I zona C  
zyra C 104, 10 000 Prishtinë  
kzap@ks-gov.net

*Gusht 2010*

## **PËRMBAJTJA**

|  |    |
|--|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....                                  | 3  |
| HYRJE.....   | 4  |
| JURISDIKSIONI I KZAP-it.....                                 | 4  |
| PËRBËRJA E PANELIT.....                                      | 5  |
| FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSIT E SEKRETARIATIT TË KZAP-it.....  | 6  |
| PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË KZAP-it.....                     | 6  |
| PROCEDURAT E KZAP-it .....                                   | 7  |
| FAKTE DHE STATISTIKA .....                                   | 7  |
| SEANCAT E PANELIT .....                                      | 7  |
| SEANCAT NË TË CILAT JANË SHQYRTUAR DHE VENDOSUR APELET:..... | 8  |
| APELET.....  | 11 |
| RASTET E PARAQITURA NË PROKURORI.....                        | 11 |
| SANKSIONET: .....  | 11 |
| RAPORTI FINANCIAR.....                                       | 13 |

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës 15 Tetor 2009 – 31 Korrik 2010, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka dëshmuar se është organ apolitik, i pavarur, i vendosur dhe i aftë në zgjidhjen e rasteve të ndryshme gjatë procesit të Zgjedhjeve Lokale 2009/2010 në mënyrë të drejtë dhe në afatet e parapara ligjore. KZAP është udhëhequr nga parimet e paanësisë politike, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Pavarësisht prej vështirësive, KZAP ka qenë në gjendje për të kryer me sukses funksionin e tij, kurse brenda periudhës së lartcekur ka vendosur rreth 550 ankesa të trajtuara me sukses, të cilat i kanë lejuar Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për Komunitetet e Republikës së Kosovës në afatin e paraparë ligjor.

KZAP brenda jurisdikcionit të tij, ka shqiptuar gjykatat ndaj subjekteve politike në shumë rreth 220.000,00 Euro. Ju është ndaluar e drejta për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme 9 përfaqësuesve të subjekteve politike, kurse në Prokurorinë e Shtetit janë dorëzuar rreth 90 raste të cilat kanë të bëjnë me rastet e përgjegjësive individuale gjatë procesit zgjedhor që janë të ndëshkueshme me Kodin Penal të Kosovës.

Të arriturat dhe rëndësia e institucionit të KZAP-it, brenda procesit zgjedhor në Republikën e Kosovës është theksuar fuqishëm edhe në raportet Freedom House dhe ENEMO-s.

## **H Y R J E**

Raporti i parë vjetor i KZAP-it për periudhën Tetor 2009-Korrik 2010, ka për qëllim pasqyrimin e gjendjes së këtij institucioni të themeluar në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Nr.03/L-073), si organ i përhershëm dhe i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

KZAP ka funksionuar në Kosovë që nga viti 2000 deri në Prill të vitit 2008, nën autoritetin e UNMIK-ut. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së) në Republikën e Kosovës më 15 Qershor 2008, KZAP, është themeluar si një organ i pavarur vendor, dhe është përcaktuar që në përbërjen e këtij organi të jenë gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe Gjykatat e Qarkut, në bazë të emërimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

Për shkak të vonesave buxhetore, KZAP nuk ishte në gjendje për të konstituuar Sekretariatit e këtij organi deri në fillim të Nëntorit 2009. Megjithatë, duke ju falënderuar asistencës dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm të Misionit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë në Kosovë (OSBE) si dhe Fondacionit Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore (IFES), Sekretariati i KZAP-it ishte në gjendje të jetë tërësisht funksional para periudhës së kampanjës zgjedhore.

Duke konsideruar që procesi i Zgjedhjeve Lokale 2009/2010 nuk ka përfunduar ende deri në përpilimin e këtij raporti, KZAP vazhdon të mbledhet në seanca të panelit në mënyrë që të shqyrtojë dhe vendos për ankesat dhe apelet e lejuara, brenda jurisdiksionit të tij.

## **JURISDIKSIONI I KZAP-it**

KZAP është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr 03/L-073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072).

Në bazë të Ligjit të cekur më lartë, neni 115, është themeluar Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (KZAP) i cili është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligj dhe rregullat zgjedhore.

Në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr 03/L-073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072), KZAP, ju përmbahet dhe zbaton me përgjegjësi Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së). Me 8 Tetor 2009 janë miratuar Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, në përputhje me nenin 117.1 të LZP-së. Kjo rregullore e punës së KZAP-it është amendamentuar me 23 Qershor 2010, bazuar në Rekomandimet e dhëna nga Misioni i OSBE-së dhe Misionet Vëzhguese Ndërkombëtare në Kosovë.

## PËRBËRJA E PANELIT

KZAP përbëhet nga pesë (5) anëtar, përfshirë edhe kryesuesin. KZAP mund të mblidhet në panele prej së paku tre (3) anëtarëve. Anëtarët e emëruar të KZAP-it në periudhën duke filluar prej gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të KZAP-it. Po ashtu, LZP-ja i obligon të gjitha autoritetet kosovare t'i ofrojnë tërë ndihmën e nevojshme KZAP-it gjatë periudhës së lartpërmendur.

KZAP përbëhet nga një Kryetar i Komisionit, i cili do të jetë kryesues në të gjitha takimet e Komisionit në përbërje të plotë, dhe nga katër anëtarë të Komisionit. KZAP mban mbledhje në panele të përbëra prej tre (3) anëtarëve të komisionit. Një (1) anëtar i komisionit emërohet kryesues i të gjitha paneleve të Komisionit. Kryetari i Komisionit do të caktojë përbërjen e paneleve. Kryetari i Komisionit mund të krijojë një panel që do të përbëhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit lidhur me çështjet e rëndësishme të jashtëzakonshme.

Anëtarët e Komisionit do t'i plotësojnë detyrat e veta me kohë dhe në mënyrë objektive, të paanshme dhe apolitike, si dhe do t'i mbajnë konfidenciale të gjitha informatat e dorëzuara tek ata në cilësinë e anëtarëve të Komisionit.

Në vitin 2008, anëtarët e KZAP-it, duke përfshirë këtu edhe kryetarin janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, siç parashihet me ligj.

Emërimi i anëtarëve të KZAP-it, është bërë në bazë të nenit 115.2 të LZP-së, i cili përcakton se: Kryetari i Gjykatës Supreme emëron anëtarët e KZAP-it nga mes i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatave të Qarkut në Kosovë.

Kryetarit i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës duke u bazuar në ligjin e lartcekur me vendimin Agj.nr.381/2008 datë 19.08.2008, ka emëruar anëtarët e KZAP-it, si në vijim:

1. Rifat Zylfiu, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, Kryesues i Komisionit,
2. Osman Tmava, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, anëtarë,
3. Muharrem Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Pejë, anëtarë,
4. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Prizren, anëtarë,
5. Fahredin Ymeri, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, anëtarë.

Në bazë të nenit 115.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr.03/L-073). Kryetari i Gjykatës Supreme me vendimin Agj.nr.627/2008 datë 03.12.2008, ka bërë zëvendësimin e Kryesuesit të Komisionit të KZAP-it për shkak të vdekjes së z.Rifat Zylfiut, duke e zëvendësuar me z.Tahir Rrecaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës Supreme i Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 115.2 të LZP-së, me vendimin Agj.nr.405/2010, me datë 05.07.2010, ka emëruar z.Shukri Sylejmani, gjyqtar i Gjykatës Supreme, në pozitën e Kryesuesit të Komisionit të KZAP-it, në vend të z.Tahir Rrecaj, për shkak të pushimit të statusit të pozitës së gjyqtarit. z. Salih Toplica, gjyqtarë i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, është emëruar anëtarë i Komisionit të KZAP-it, në vend të Osman Tmaves për shkak të vdekjes së tij. Po ashtu në bazë të vendimit 434/2010 të datës

12.07.2010, z. Muhamet Rexha, gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan është emëruar anëtarë i Komisionit të KZAP-it në vend të Fahredin Ymerit, për shkak të pushimit të statusit të gjyqtarit.

### **FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSIT E SEKRETARIATIT TË KZAP-it**

Në bazë të LZP-së, neni 123, KZAP ndihmohet në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të tij nga Sekretariati i cili punon në pajtim me këtë ligj.

Sekretariati i KZAP-it:

- a) pranon ankesa dhe apele;
- b) arkivon, përkthen dhe harton rastet;
- c) mirëmban adresa zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë rreth vendimeve të KZAP-it në të gjitha gjuhët zyrtare sipas Ligjit për Përdorimin e gjuhëve.

Kryesuesi i Sekretariatit të KZAP-it nën udhëheqjen e Kryetarit të KZAP-it, është përgjegjës për:

- a) të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e KZAP-it;
- b) përgatitjen e paneleve të KZAP-it duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- c) organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e KZAP-it.
- d) Për menaxhimin e buxhetit vjetor të ndarë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e duhur të Sekretariatit, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

### **PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË KZAP-it**

Sekretariati i KZAP-it, me organogram dhe buxhet për vitin 2010 ka të planifikuara dhe të miratuara 10 (dhjetë) pozita. Një Kryesues të Sekretariatit dhe 9 (nëntë) anëtarë të administratës së këtij sekretariati.<sup>1</sup>

Sekretariati i KZAP-it, ka filluar të funksionoj më emërimin e Kryesuesit të Sekretariatit, z. Mulë Desku, i cili ka filluar punën më datë 09.11.2009. Pastaj më 15.01.2010 Sekretariati i KZAP-it, ka rekrutuar respektivisht ka emëruar, dy Zyrtarë të Lartë Ligjorë dhe një Përkthyes, Shqip Serbisht dhe anasjelltas, ndërsa më datë 01.03.2010 janë rekrutuar edhe dy anëtarë tjerë të personelit, një Arkivist&Asistent Ekzekutiv dhe një Shofer&Shpërndarës i Postës. Më datë 07.06.2010 është rekrutuar një Zyrtar për Teknologji Informative dhe Logjistikë. Sekretariati i KZAP-it deri më 31.07.2010 ende nuk është kompletuar në tërësi, siç parashihet në organogram dhe buxhet ku janë të planifikuar edhe 3 (tre) nëpunës civil, të cilët do të rekrutohen në një periudhë të afërm kohore.

<sup>1</sup> Nga 5 Tetori 2009, Sekretariati i KZAP-it ka qenë i mbështetur nga Divizioni i Zgjedhjeve të Misionit të OSBE-së, respektivisht nga 1 këshilltarë ligjor ndërkombëtarë dhe dy këshilltarë lokal

Për arsye të kufizimit të numrit të punëtorëve, respektivisht numrit të vogël të punëtorëve të lejuar me buxhet, dhe me qëllim të ruajtjes së buxhetit të Kosovës, një anëtarë i personelit i ka dy funksione.

## **PROCEDURAT E KZAP-it**

Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel, KZAP ka shqyrtuar dhe hetuar të gjitha dëshmitë relevante që kanë qenë të nevojshme për marrjen e një vendimi. Vendosja për ankesa dhe apele është mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse. Vendimet e KZAP-it janë publikuar në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e KZAP-it, përkatësisht në bazë të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës.

KZAP ka përdorur dy metoda kryesore për të mbledhur faktet e nevojshme në mënyrë që të shqyrtojë ankesat dhe të nxjerr vendime. Në lidhje me hetimin e materialit zgjedhor, siç përcaktohet në Nenin 12 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, kur një ankesë e dyshuar për veprimtari mashtruese që përfshinë materialin zgjedhor, Kryetar i Komisionit apo Kryesuesi i Panelit ka caktuar një anëtar të Sekretariatit të KZAP-it si hetues kryesor në lidhje me atë ankesë. Së dyti, KZAP në mënyrë të rregullt ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, në veçanti në lidhje me rastet e dyshuara të kërcënimeve, shantazheve dhe dëmtimit të pronës publike, kurse bazuar në raportet hetimore të Policisë KZAP ka marrë vendime në lidhje me rastet e specifikuar më lartë.

## **FAKTE DHE STATISTIKA**

Më poshtë, mund të gjenden fakte dhe statistika të cilat në mënyrë të hollësishme shpjegojnë seancat e paneleve të mbajtura, llojet e ankesave dhe apeleve të pranuar, rastet e paraqitura në Prokurorinë e Shtetit si dhe tabela e gjobave ndaj subjekteve politike, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur.

## **SEANCAT E PANELIT**

Paneli i KZAP-it sipas nevojës dhe arsyes si dhe varësisht prej numrit të rasteve ka mbajtur seanca, deri tri herë në javë.

Për procesin zgjedhor 2009, Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunave KZAP ka mbajtur:

Gjithsejtë 29 seanca, duke filluar nga 13.10.2009 deri me 23.07.2010.

- 1) Me 13.10.2009 janë shqyrtuar 3 ankesa dhe janë marrë 3 vendime,
- 2) Me 20.10.2009 janë shqyrtuar 5 ankesa dhe janë marrë 5 vendime,
- 3) Me 26.10.2009 janë shqyrtuar 4 ankesa dhe janë marrë 4 vendime,
- 4) Me 02.11.2009 janë shqyrtuar 12 ankesa dhe janë marrë 12 vendime,
- 5) Me 09.11.2009 janë shqyrtuar 15 ankesa dhe janë marrë 15 vendime,
- 6) Me 12.11.2009 janë shqyrtuar 6 ankesa dhe janë marrë 6 vendime,
- 7) Me 16.11.2009 janë shqyrtuar 7 ankesa dhe janë marrë 7 vendime,
- 8) Me 19.11.2009 janë shqyrtuar 21 ankesa dhe janë marrë 21 vendime,
- 9) Me 21.11.2009 janë shqyrtuar 15 ankesa dhe janë marrë 15 vendime,
- 10) Me 23.11.2009 janë shqyrtuar 22 ankesa dhe janë marrë 22 vendime,
- 11) Me 24.11.2009 është shqyrtuar 1 ankesa dhe është marrë 1 vendim,
- 12) Me 26.11.2009 janë shqyrtuar 35 ankesa dhe janë marrë 35 vendime,
- 13) Me 30.11.2009 janë shqyrtuar 30 ankesa dhe janë marrë 30 vendime,
- 14) Me 03.12.2009 janë shqyrtuar 19 ankesa dhe janë marrë 19 vendime,
- 15) Me 07.12.2009 janë shqyrtuar 30 ankesa dhe janë marrë 28 vendime,
- 16) Me 10.12.2009 janë shqyrtuar 33 ankesa dhe janë marrë 33 vendime,
- 17) Me 14.12.2009 janë shqyrtuar 49 ankesa dhe janë marrë 49 vendime,
- 18) Me 17.12.2009 janë shqyrtuar 12 ankesa dhe janë marrë 12 vendime,
- 19) Me 19.12.2009 janë shqyrtuar 43 ankesë dhe është marrë 1 vendim,
- 20) Me 21.12.2009 janë shqyrtuar 20 ankesa dhe janë marrë 20 vendime,
- 21) Me 22.12.2009 janë shqyrtuar 15 ankesa dhe janë marrë 15 vendime,
- 22) Me 24.12.2009 janë shqyrtuar 20 ankesa dhe janë marrë 20 vendime,
- 23) Me 30.12.2009 janë shqyrtuar 6 ankesa dhe janë marrë 6 vendime,
- 24) Me 19.04.2010 janë shqyrtuar 4 ankesa dhe janë marrë 4 vendime,
- 25) Me 04.05.2010 janë shqyrtuar 3 ankesa dhe janë marrë 3 vendime,
- 26) Me 21.05.2010 janë shqyrtuar 2 ankesa dhe janë marrë 2 vendime,
- 27) Me 25.06.2010 është shqyrtuar 1 ankesë dhe është marrë 1 vendim,
- 28) Me 16.07.2010 janë shqyrtuar 5 ankesa dhe janë marrë 5 vendime,
- 29) Me 23.07.2010 janë shqyrtuar 3 ankesa dhe janë marrë 3 vendime.

**Gjatë mbajtjes së këtyre Seancave paneli i KZAP-it ka shqyrtuar 544 ankesa dhe Lidhur me këto ankesa ka marr vendime meritore.**

**SEANCAT NË TË CILAT JANË SHQYRTUAR DHE VENDOSUR APELET:**

- 1) Me datën 03.12.2009 janë shqyrtuar 3 apele dhe janë marrë 3 vendime,
- 2) Me datën 07.12.2010 është shqyrtuar 1 apel dhe është marrë 1 vendim,
- 3) Me datën 14.12.2009 janë shqyrtuar 2 apele dhe janë marrë 2 vendime,
- 4) Me datën 22.12.2010 është shqyrtuar 1 apel dhe është marrë 1 vendim,



- 5) Me datën 30.12.2010 është shqyrtuar 1 apel dhe është marrë 1 vendim,
- 6) Me datën 21.01.2010 janë shqyrtuar 2 apele dhe janë marrë 2 vendime,
- 7) Me datën 18.03.2010 janë shqyrtuar 5 apele dhe janë marrë 5 vendime,
- 8) Me datën 19.04.2010 janë shqyrtuar 2 apele dhe janë marrë 2 vendime,
- 9) Me datën 04.05.2010 është shqyrtuar 1 apel dhe është marrë 1 vendim,
- 10) Me datën 21.05.2010 është shqyrtuar 1 apel dhe është marrë 1 vendim,
- 11) Me datën 09.06.2010 është shqyrtuar 1 apel dhe është marrë 1 vendim,

Gjatë periudhës 2009-2010, llojet e Ankesave dhe Parashtresave të pranuar në KZAP kanë qenë: Kodi i Mirësjelljes – 73; Raporti i Deklarimit të Fushatës Financiare – 40; Kërcënim – 50; Parregullsi gjatë procesit të votimit – 292; Mospërputhje gjatë numërimit – 60; Shpërndarja e gabueshme e vendeve/Asamble Komunale – 10; të tjera – 26.

Në kategorinë e shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes – respektivisht gjatë kohës së Heshtjes Zgjedhore janë pranuar 13 ankesa; Shpifje/Nxitje – 6; Mbulim i afisheve/afishe në publik – 43; të tjera – 11.

Në kategorinë e ankesave të dyshuara për mospërbushje të afatit ligjor lidhur me publikimin e Raportit Financiar për vitin 2009-2010, KZAP ka pranuar gjithsej 40 ankesa nga Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike në KQZ.

Në kategorinë e ankesave të dyshuara për kërcënim dhe frikësim gjatë Procesit Zgjedhor 2009-2010, KZAP ka pranuar gjithsej 50 ankesa.

Në kategorinë e ankesave të dyshuara për parregullsi gjatë procesit të votimit, KZAP për vitin 2009-2010 ka pranuar 292 ankesa.

KZAP ka konstatuar si ankesa të pabazuara gjithsej 429; ankesa që rezultuan në gjoba gjithsej 64; ankesa që rezultuan në rivotim gjithsej 42 dhe ankesa që rezultuan në rinumërim/anulim gjithsej 9.

Ankesat totale gjatë periudhës 2009-2010, të pranuar nga KZAP janë 544.

**Lista e mëposhtme vërteton ankesat e ardhura nga secila komunë veç e veç:**

| <b>Ankesat ne KZAP - Lista e pikave të ndjeshme për çdo Komunë</b> |    |
|--|----|
| Dragash  | 2  |
| Fushë Kosove   | 14 |
| Ferizaj  | 21 |
| Gjakove  | 26 |

|               |    |
|---------------|----|
| Gjilan        | 54 |
| Glllogovc     | 2  |
| Gracanice     | 23 |
| Hani i Elezit | 4  |
| Istog         | 12 |
| Junik         | 0  |
| Kamenicë      | 10 |
| Kaçanik       | 15 |
| Kline         | 7  |
| Klllokot      | 0  |
| Leposaviq     | 0  |
| Lipjan        | 48 |
| Malisheve     | 25 |
| Mamush        | 0  |
| Mitrovice     | 7  |
| Novobërde     | 0  |
| Obiliq        | 5  |
| Patesh        | 14 |
| Pejë          | 16 |
| Podujeve      | 21 |
| Prishtine     | 64 |
| Prizren       | 58 |
| Rahovec       | 15 |
| Ranilluk      | 0  |
| Shtime        | 12 |
| Shtërpce      | 8  |
| Skenderaj     | 19 |
| Suhareke      | 31 |
| Viti          | 11 |
| Vushtrri      | 9  |
| Zubin Potok   | 0  |
| Zveçan        | 0  |

## APELET

Sipas shënimeve dhe informatave zyrtare që kemi aktualisht në Gjykatën Supreme të Kosovës janë ushtruar, paraqitur 25 padi, lidhur me zgjedhjet Lokale 2009/2010. Gjykata Supreme e Kosovës ka afirmuar të gjitha vendimet e KZAP-it.

## RASTET E PARAQITURA NË PROKURORI

Shkeljet e Kodit të Sjelljes të cilat kanë tentuar të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve e që paraqesin vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës, KZAP, për shkak të dyshimeve të bazuara i ka dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit 89 raste. Është në kompetencë të Prokurorisë së Shtetit procedimi i këtyre rasteve me tutje. KZAP, nuk ka informata kthyesë se në çfarë faze të procedurës janë këto raste për arsye se Prokuroria e Shtetit nuk ka përgjegjësi për ta informuar.

## SANKSIONET:

Gjobat shqiptuara ndaj Subjekteve Politike

| Nr                 | Subjekti politik   | Shuma e gjobës      | Pagesa e gjobës     | Mbetja e borxhit   |
|--------------------|--------------------|---------------------|---------------------|--------------------|
| 1.                 | AAK                | 12,720.00 €         | 12,720.00 €         | 00                 |
| 2.                 | PDK                | 85,620.00 €         | 69,920.00 €         | 15,700.00 €        |
| 3.                 | AKR                | 21,600.00 €         | 21,600.00 €         | 00                 |
| 4.                 | LDK                | 48,900.00 €         | 34,200.00 €         | 14,700.00 €        |
| 5.                 | LDD                | 9,500.00 €          | 9,500.00 €          | 00                 |
| 6.                 | ADK                | 3,200.00 €          | 00                  | 3,200.00 €         |
| 7.                 | BUK                | 1,500.00 €          | 00                  | 1,500.00 €         |
| 8.                 | DRK                | 1,500.00 €          | 00                  | 1,500.00 €         |
| 9.                 | PDKI               | 3,200.00 €          | 00                  | 3,200.00 €         |
| 10.                | PLK                | 4,800.00 €          | 00                  | 4,800.00 €         |
| 11.                | PRSH               | 1,500.00 €          | 00                  | 1,500.00 €         |
| 12.                | PSD                | 530.00 €            | 00                  | 530.00 €           |
| 13.                | RRKPZ              | 4,800.00 €          | 00                  | 4,800.00 €         |
| 14.                | SDP                | 3,200.00 €          | 00                  | 3,200.00 €         |
| 15.                | ZBB                | 500.00 €            | 00                  | 500.00 €           |
| 16.                | ZEG                | 500.00 €            | 00                  | 500.00 €           |
| 17.                | GIO                | 500.00 €            | 00                  | 500.00 €           |
| 18.                | IQK                | 500.00 €            | 00                  | 500.00 €           |
| 19.                | JSŽ                | 500.00 €            | 00                  | 500.00 €           |
| 20.                | IRDK               | 3,200.00 €          | 3,200.00 €          | 00                 |
| 21.                | Bajram Islami      | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 22.                | Sabahudin Cirkovic | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 23.                | Mexhit Foniqi      | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 24.                | Nevzat Hydaverdi   | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 25.                | Adem Haxhi Gashi   | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 26.                | Naim Mustafa       | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 27.                | Hasan Bilalli      | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 28.                | Ahmet Krasniqi     | 200.00 €            | 00                  | 200.00 €           |
| 29.                | Sakip Makasqi      | 300.00 €            | 00                  | 300.00 €           |
| <b>Gjithsejtë:</b> |                    | <b>210,170.00 €</b> | <b>151,140.00 €</b> | <b>59,030.00 €</b> |

KZAP ka autoritet ligjor të marrë vendime në pretendimet se janë shkelur dispozitat e Kodit Sjelljes si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me ligj.

Sipas shënimeve dhe informatave që KZAP posedon, deri në përgatitjen e këtij raporti, për shkak të shkeljes së dispozitave të LZP, KZAP ka shqiptuar gjopa Subjekteve Politike dhe atë si në vijim:

Shuma e gjobave të shqiptuara ndaj Subjekteve Politike është gjithsejtë: 210,170.00 €

Shuma e gjobave të paguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë: 151,140.00 €

Shuma e gjobave të papaguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë: 59,030.00 €

Subjektet Politike shumat e gjobave i kanë paguar në llogari të Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës në Xhirollogarinë : 1000400070003381.

**Emrat dhe mbiemrat e personave te cilëve iu ndalohe te marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme:**

1. Qerim Gara dy vite Subjekti politik BDA,
2. Bekim Gara dy vite Subjekti politik BDA,
3. Bajram Gashi katër vite i ndalohe kandidimi subjekti politik PDK,
4. Avni Gashi gjashtë vite i ndalohe pjesëmarrja aktive në zgjedhje subjekti politik PDK,
5. Xhelal Krasniqi katër vite i ndalohe kandidimi në zgjedhje dhe gjashtë vite pjesëmarrja aktive në zgjedhje, subjekti politik LDK,
6. Valon Dalipi dy vite pjesëmarrja aktive në zgjedhje,
7. Jakup Sfarça tri vite i ndalohe kandidimi në zgjedhje dhe gjashtë vite pjesëmarrja aktive në zgjedhje, subjekti politik LDK,
8. Jeton Sfarça tri vite i ndalohe kandidimi në zgjedhje dhe gjashtë vite pjesëmarrja aktive në zgjedhje, subjekti politik LDK,
9. Shaban Sfarça tri vite i ndalohe kandidimi në zgjedhje dhe gjashtë vite pjesëmarrja aktive në zgjedhje, subjekti politik LDK.

## RAPORTI FINANCIAR

### RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2009<sup>2</sup>

|   |                      |
|---|----------------------|
| Buxheti i KZAP-it për vitin 2009 ka qene gjithsejtë:    | 197,384 €            |
| Pagesat e Përgjithshme:                                 | 58,473.00 € - 29.6 % |
| Për paga janë shpenzuar gjithsejtë:                     | 32,153.00 € – 63.3 % |
| Mallra dhe Shërbime janë shpenzuar gjithsejtë:          | 16,973.00 € – 18.1 % |
| Shpenzime Komunale janë shpenzuar gjithsejtë:           | 33.00 € – 0.3 %      |
| Shpenzime Kapitale janë shpenzuar gjithsejtë:<br>22.2 % | 9,314.00 € –         |

### RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2010

|   |              |
|---|--------------|
| Buxheti i KZAP-it për vitin 2010 është                                    | 171,874.78 € |
| Pagesat e Përgjithshme deri në muajin Korrik 2010:                        | 38,352.32 €  |
| Për paga deri në muajin Korrik 2010 janë shpenzuar gjithsejtë:            | 30,393.90 €  |
| Mallra dhe Shërbime deri në muajin Korrik 2010 janë shpenzuar gjithsejtë: | 7,136.30 €   |
| Shpenzime Komunale deri në muajin Korrik 2010 janë shpenzuar gjithsejtë:  | 822.12 €     |
| Shpenzime Kapitale deri në muajin Korrik 2010 janë zotuar gjithsejtë:     | 63,000.00 €  |

#### Trendët historike të financimit

|                     | 2008 | 2009 Rishikim | 2010    |
|---------------------|------|---------------|---------|
| Total               |      | 197,384       | 270,191 |
| Paga dhe shtesa     |      | 50,784        | 93,281  |
| Mallra dhe shërbime |      | 93,600        | 100,210 |
| Shërbimet komunale  |      | 11,000        | 9,200   |
| Kapital             |      | 42,000        | 67,500  |
| Numri i stafit      |      | 5             | 15      |

#### Vlerësimet për KASH-i

|                     | 2010    | 2011    | 2012    | 2013    |
|---------------------|---------|---------|---------|---------|
| Total               | 270,191 | 242,083 | 202,691 | 202,691 |
| Paga dhe shtesa     | 93,281  | 96,895  | 96,895  | 96,895  |
| Mallra dhe shërbime | 100,210 | 97,888  | 97,296  | 97,296  |
| Shërbimet komunale  | 9,200   | 7,300   | 8,500   | 8,500   |
| Kapital             | 67,500  | 40,000  |         |         |
| Numri i stafit      | 15      | 16      | 16      | 16      |

#### Kufijtë e vlerësuar të shpenzimeve 2011-13

|          | 2010    | 2011    | 2012    | 2013    |
|----------|---------|---------|---------|---------|
| Total    | 270,191 | 202,083 | 202,691 | 202,691 |
| Operativ | 202,691 | 252,225 | 202,691 | 202,691 |
| Kapital  | 67,500  | 40,000  |         |         |

<sup>2</sup> Llogaritjet në përqindje tek Shpenzimet Financiare 2009 janë bere për secilën kategori ekonomike.